



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2023

VENDIM

Nr. 389, datë 17.07.2023

PËR

**NGRITJEN NË DETYRËN E GJYQTARES SË GJYKATËS SË POSAÇME
TË SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR TË
ZNJ. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 4, të nenit 135, pikën 1, të nenit 147, në shkronjën “a”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 3, të nenit 104, të Kodit të Procedurave Administrative, në shkronjën “ç”, të nenit 85 e 86 dhe nenet 97 e 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikën 9,10 dhe 14, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, në përfundim të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e tij nr. 287, datë 06.07.2023, mbi propozimin e relatorit të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve,

VENDOSI:

1. Ngritjen në detyrën e gjyqtares së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të znj. {...}.
2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 17.07.2023.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR